



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 934/2Prot.

Tiranë, më 03. 12 . 2024

V E N D I M

Nr. 298, Datë 03. 12 . 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>1</sup>, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.138 Regj., datë 20.06.2024, e znj. S. G.<sup>2</sup>, kundër Bashkisë Durrës, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Durrës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me pretendimin se ankuesja është diskriminuar për shkak të etnisë, gjendjes ekonomike, familjare dhe çdo shkak tjetër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

K O N S T A T O I:

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi shpjegon se: *Organizata “Drejtësi Sociale” ka në fokus kryesor advokimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, veçanërisht për minoritetet romë dhe egjiptiane. Nga puna jonë në terren në qytetin e Durrësit, kemi identifikuar rastin e familjes G., e cila pretendohet si rast diskriminimi.*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD;

<sup>2</sup> Përfaqësuar në këtë ankesë nga Organizata "Drejtësi Sociale", me përfaqësues nga z. G. S.

<sup>3</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

*Në emër të organizatës “Drejtësi Sociale”, po paraqesim këtë ankesë për diskriminim dhe ndërprerje të padrejtë të ndihmës ekonomike për zonjën S. G., banuese në Bashkinë Durrës.*

*Zonja G., është një nënë kryefamiljare që kujdeset për dy vajzat e saj, njëra prej të cilave është në gjendje të rëndë shëndetësore dhe kërkon kujdes të vazhdueshëm. Ajo ka përfituar ndihmë ekonomike për shkak të pamundësisë për të punuar, duke qenë e angazhuar në kujdesin e vajzës së saj të sëmurë. Ndihma ekonomike është thelbësore për mbijetesën e familjes së saj dhe mbulimin e nevojave bazë.*

*Megjithatë, në muajin e fundit, ndihma ekonomike e zonjës G., është ndërprerë papritur pa asnjë njoftim paraprak nga administrata. Sipas informacionit të marrë (informalisht) nga administrata sociale, arsyeja e ndërprerjes është se vajza e saj mbushi moshën 18 vjeç dhe duhet të regjistrohej si punëkërkuese pranë zyrës së punës. Zonja G., për shkak të mungesës së arsimit dhe informacionit, nuk e kishte ditur që duhej të regjistronte vajzën si punëkërkuese, dhe nuk ishte njoftuar për këto procedura nga institucionet. Si rezultat, ndihma ekonomike e saj është ndërprerë për një periudhë 6-mujore.*

*Mungesa e njoftimit dhe informimit të duhur për procedurat që duhet të ndiqen për të ruajtur përfitimin e ndihmës ekonomike, përbën një shkelje të të drejtave të zonjës G., dhe një akt diskriminimi ndaj familjes së saj. Ajo është lënë në një gjendje të pasigurt dhe të paqëndrueshme ekonomike, duke rrezikuar mirëqenien e saj dhe të vajzave të saj.*

*Përfundimisht, pala ankuese kërkon nga Komisioneri pranimin e kërkesë, konstatimin e diskriminimit, dhënien e një vendimi diskriminimi kundër Bashkisë Durrës, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Durrës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për shkak të etnisë, gjendjes ekonomike, familjare dhe çdo shkak tjetër.*

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën e sipërcituar, në referencë të kompetencës së parashikuar në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i atribuon të drejtën të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sikurse parashikohet në këtë ligj.

Ligji nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes civile” dhe “gjendjes shëndetësore” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat

*e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Neni 5, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji. Sipas këtij neni ndalohet gjithashtu mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, të një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje, që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Neni 7, i LMD, të ndryshuar, parashikon shprehimisht: “1. Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim. 2. Eliminimi i të gjitha privilegjeve dhe i diskriminimit të padrejtë, garantohet për cilindo, në bazë të të drejtave vetjake, politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të siguruara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi. 3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”

Në Kreun III, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, të tij parashikon se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.”

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit të ankesës nr.138 Regj., datë 20.06.2024, nga Organizata "Për Drejtësi Sociale", përfaqësuar nga z. G. S., i cili është autorizuar të përfaqësojë në këtë ankesë znj. S. G., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>4</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Bashkisë Durrës, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Durrës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe për dijëni ankuesit, me shkresën nr. 934/1, datë 18.10.2021, ku kërkohet informacion, si më poshtë vijon:

- Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e ngritura në këtë ankesë.
- Informacion mbi shkaqet ligjore pse znj. G., është përjashtuar nga skema e personave që përfitojnë ndihmën ekonomike, dhe nëse po arsyet e këtij përjashtimi. Kopje të praktikës dhe dokumentacionit të marrë në shqyrtim në lidhje me këtë çështje.
- Informacion në lidhje me qëndrimin dhe praktikën e ndjekur për këto raste nga institucionet sipas kompetencave ligjore të secilit, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
- Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

Me shkresën nr.2140/1 prot., datë 27.06.2024<sup>5</sup> të Drejtorisë Rajonal Durrës është përcjellë pranë Komisionerit informacioni i kërkuar me shkresën nr.934/1 prot., datë 20.06.2024, në lidhje me ankesën, nëpërmjet së cilës sqaron se: *Familja e zonjës S. G., e përbërë nga 5 anëtarë, ka aplikuar për herë të parë për ndihmë ekonomike më datë 05.05.2020 dhe ka qenë përfituese e ndihmës ekonomike me vlerën prej 10.692 lekë deri më datën 30.04.2024.*

*Në muajin maj 2024, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Durrës, në zbatim të VKM 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu II, pika 8, shkronja (a), kreu verifikimet përkatëse. Nga verifikimet rezultoi se zonja A. G., (vajza e zonjës S. G.) nuk është regjistruar në sistemin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).*

*Në zbatim të VKM 597, datë 04.09.2019, kreu II, pika 11, shkronja (e), përcaktohet se përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet që kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme: anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës ose të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi dhe banojnë në fshat.*

---

<sup>4</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon: “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

<sup>5</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 943/2 prot., datë 01.07.2024

*Për shkak se zonja A. G. nuk është regjistruar pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), familja e zonjës Sonila Gashi përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore.*

3. Me shkresën nr.7962/1 prot., datë 03.07.2024 të Bashkisë Durrës është përcjellë pranë Komisionerit informacioni i kërkuar me shkresën nr.934/1 prot., datë 20.06.2024<sup>6</sup>, nëpërmjet së cilës sqaron se:

*Familja e zonjës S. G., e përbërë nga 5 anëtarë, ka aplikuar për herë të parë për ndihmë ekonomike më datë 05.05.2020 dhe ka qenë përfituese e ndihmës ekonomike me vlerën prej 10.692 lekë deri më datën 30.04.2024. Në muajin maj 2024, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Durrës, në zbatim të VKM 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", kreu II, pika 8, shkronja (a), kreu verifikimet përkatëse. Nga verifikimet rezultoi se zonja A. G., (vajza e zonjës S. G.) nuk është regjistruar në sistemin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).*

*Në përputhje me VKM 597, datë 04.09.2019, kreu II, pika 11, shkronja (e), përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet që kanë në përbërje të tyre edhe një anëtar të vetëm që plotëson kushtet e mëposhtme: anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë pranë zyrave të punës ose të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, përveç rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi dhe banojnë në fshat.*

*Duke marrë parasysh se zonja A. G., nuk është regjistruar pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), familja e zonjës S. G., përjashtohet nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë 6-mujore. Gjithashtu, zonja S. G., është njoftuar dhe informuar për arsyet e mos përfitimit të ndihmës ekonomike.*

4. Me shkresën nr.2924/2 prot., datë 02.07.2024<sup>7</sup> të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përcjellë pranë Komisionerit informacioni i kërkuar me shkresën nr.934/1 prot., datë 20.06.2024, nëpërmjet së cilës sqaron se:

*Në zbatim të Ligjit nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", të ndryshuar, përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike për një periudhë gjashtëmujore familjet që kanë anëtarë në moshë aktive pune të aftë për punë, që nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë pranë zyrave të punës ose*

<sup>6</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 943/3 prot., datë 04.07.2024

<sup>7</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 943/4 prot., datë 04.07.2024

*të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve. Përjashtim bëjnë familjet që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi dhe banojnë në fshat, si dhe ato familje që kanë anëtarë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë ose të lartë, por jo më shumë se deri në moshën 25 vjeç.*

*Sistemi i menaxhimit të informacionit të ndihmës ekonomike ndërvepron me sistemin elektronik të punësimit për verifikimin e listës së punëkërkuësve të papunë, aplikues dhe përfitues të skemës së ndihmës ekonomike. Ky veprim kryhet rregullisht për të gjithë aplikuesit dhe përfituesit e skemës dhe nuk përbën diskriminim për asnjë individ për shkak të etnisë, gjendjes ekonomike, apo çdo arsye tjetër.*

*Shërbimi Social Shtetëror Rajonal kryen takime dhe trajnime të vazhdueshme me administratorët socialë të njësive vendore administrative, me qëllim zbatimin e legjislacionit dhe informimin e aplikuesve dhe përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike.*

5. Me shkresën nr. 934/5 prot., datë 05.07.2024 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i janë përcjellë Organizatës “Për Drejtësi Sociale”, shkresat e institucioneve për të paraqitur kundërshtimet lidhur me këto përgjigje.

6. Duke marrë shkas nga moskthimi i një përgjigje lidhur me paraqitjen e kundërshtimeve nga pala ankuese nga ana e inspektorit të çështjes iu dërgua një e-mail në datën 26.07.2024 “Për rikujtesë”.

7. Me e-mail e datës 26.07.2024 pala ankuese përcolli pranë Komisionerit parashtrimet e tyre në lidhje me qëndrimet e institucioneve për rastin objekt ankimi, duke parashtruar se: *Referuar përgjigjeve të ardhura nga institucionet, mund të themi se nuk është ofruar asnjë informacion mbi mënyrën sesi informohen familjet rome dhe egjiptiane kur një nga anëtarët e familjes mbush moshën 18-vjeçare dhe duhet të regjistrohet në zyrën e punës. Mungesa e informacionit për zonjën G., lidhur me regjistrimin e vajzës së saj në zyrën e punës, e penalizoi atë me mospranimin e ndihmës ekonomike për 6 muaj. Mospërcaktimi i një praktike për njoftimin e familjeve mbi këto procedura, në mendimin tonë, është një sjellje diskriminuese. Përjashtimi për 6 muaj nga ndihma ekonomike për arsye të mosregjistrimit të vajzës në zyrën e punës, si pasojë e mungesës së informacionit, gjithashtu konsiderohet një sjellje diskriminuese.*

Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”<sup>8</sup>, të ndryshuar, dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri pasi vlerësoi kërkesën e palës ankuese, caktoi datën 26.09.2024 ora 10.00 për zhvillimin e seancës dëgjimore dhe njoftoi palët me shkresën nr.934/6 prot., datë 04.09.2024.

---

<sup>8</sup> Neni 33/8, ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”

Me shkresën nr.10244/1 prot., datë 23.09.2024<sup>9</sup>, Bashkia Durrës njoftoi Komisionerin se do të përfaqësohej në seancën dëgjimore të datës 26.09.2024 nga znj. M. R., Shefe e Pagesave të Ndihmës Ekonomike dhe PAK si dhe znj. Z. B., Administratore Sociale në Njësinë Administrative nr.5.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 26.09.2024, me praninë e palës ankuese Organizatës Drejtësi Sociale përfaqësuesve me autorizim<sup>10</sup> znj. Gj. B., dhe z. E L., dhe palës kundër të cilës është bërë ankimi Bashkisë Durrës përfaqësuar nga znj. M. R., Shefe e Pagesave të Ndihmës Ekonomike dhe PAK si dhe znj. Z. B., Administratore Sociale në Njësinë Administrative nr.5, DRSSH Durrës përfaqësuar nga z. D. K., Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk mori pjesë në këtë seancë dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me *e-mail* me Komisionerin.

## **I. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

### **1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuses.**

Ligji nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, zbatohet për individët, familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Shqipërisë dhe nënat me foshnja të porsalindura, për ofrimin dhe garantimin e asistencës sociale.

Neni 7 i këtij ligji parashikon shprehimisht se:

*“Përfituesit e ndihmës ekonomike janë:*

- a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;*
- b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;*
- c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;*
- ç) viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;*

<sup>9</sup> Administruar pranë Komisionerit me nr. 943/7 prot., datë 25.09.2024

<sup>10</sup> Autorizim i datë 25.09.2024 i Drejtorit Ekzekutiv të organizatës “Drejtësi Sociale”, z. G. S.

*d) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.”*

Neni 12, pikat 1-2, të ligjit të sipërcituar parashikojnë gjithashtu se ndihma ekonomike është një pagesë që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara në nenin 7, të këtij ligji. Ndhimja ekonomike, që përfitojnë familjet dhe individët në nevojë, është e plotë dhe masa nuk kufizohet për shkak të numrit të anëtarëve. Ndhimë ekonomike përfitojnë familjet që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme nga programet e mbrojtjes shoqërore, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia apo të ardhura të tjera, dhe individët e përcaktuar në nenin 7, të këtij ligji.

Kategoritë e individëve që mund të aplikojnë për të përfituar ndihmë ekonomike, si dhe mënyrën se si bëhet pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike, përcaktohet shprehimisht në nenin 16, pikat 1-3, të ligjit të sipërcituar, ku parashikohet se:

*1. Kërkesa për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet nga:*

*a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm, kur nuk ka bashkëshort/e;*

*b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martese dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë;*

*c) nga vetë individi, sipas përcaktimeve në shkronjat “b”, “ç” e “d”, të nenit 7.*

*2. Aplikimi për të përfituar ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative, nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin. Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimin e ndihmës ekonomike, si dhe masa e përfitimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

*3. Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike bëhet nëpërmjet formulës së pikëzuar, treguesit e së cilës mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

Në Vendimin nr. 956, datë 7.12.2016, e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të detajeve të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike” parashikohet se formula e unifikuar e pikëzimit përfshin parametra të lidhur në mënyrë empirike me vlerësimin e situatës ekonomike të familjeve, të tilla si: të ardhurat nga programi i mbrojtjes sociale, remitancat, qiraja, asetet, bujqësia, blegtoria, trashëgimia dhe dhuratat. Treguesit e vlerësimit, pjesë e formulës së unifikuar të pikëzimit, që ndihmojnë në përcaktimin e kriterëve të pranueshmërisë së familjeve për përfitimin e ndihmës ekonomike, përcaktohen sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi. Në këtë kontekst, është pikërisht sistemi zbatues i kësaj formule, që përzgjedh familjet përfituese të ndihmës ekonomike.

Në zbatim të ligjit nr. 57, datë 18.07.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” është miratuar Vendimi nr. 597, datë 04.09.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e



*procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”. Kreu I, pika 2, germa a), e VKM-së sipërcituar, përcakton se: “...përfituesit e ndihmës ekonomike janë....(a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.”*

Ndër të tjera, në këtë VKM, në Pjesën II përcaktohet edhe procedura e aplikimit për ndihmë ekonomike. Gjatë kësaj procedure, theksohet roli tepër i rëndësishëm i administratorit shoqëror. Administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, të dhënat e mëposhtme: a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, dhe që përmbledh informacionin për: i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin; ii) llojin e banesës; iii) pasuritë/asetet familjare; iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera. Njëkohësisht, administratori shoqëror, pasi verifikon situatën social ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren, brenda muajit të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat sipas formularit në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Administratori shoqëror paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike;

Në pikën 8, të Pjesës II, të VKM-së së sipërcituar parashikohen edhe funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për realizimin e procesit të vendimmarrjes për përfituesit e ndihmës ekonomike. Kështu, kjo strukturë ka përgjegjësitë e mëposhtme: a) verifikon të dhënat e regjistruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë në Regjistrin Elektronik Kombëtar, si dhe konfirmon saktësinë e tyre pranë autoriteteve shtetërore përgjegjëse dhe në bazë të aplikimit të formulës së pikëzuar për familjet në nevojë; b) merr vendime për caktimin e familjeve/individëve në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike, masën e përfitimit të tyre si edhe refuzon kërkesën për dhënien e përfitimit të ndihmës ekonomike të shoqëruar me arsyet e refuzimit, sipas formatit në shtojcën 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi; c) ia dërgon vendimin kryetarit të bashkisë për të njoftuar kërkuessit për përfitimin e ndihmës ekonomike ose për të kryer veprimet financiare për pagesën për përfituesit e ndihmës ekonomike. Procesi i vendimmarrjes kryhet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror brenda muajit të aplikimit të qytetarëve për ndihmë ekonomike. Referuar germës b), të pikës 8, të kësaj VKM-je, duhet vënë në dukje fakti se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror merr vendime në bazë të rezultateve të dala nga sistemi elektronik i pikëzimit, si dhe përcakton masën e përfitimit apo refuzimit të kërkesës së familjeve aplikuese në bazë të parashikimeve ligjore.

Për sa më sipër, rezulton se familja e znj. S. G., ka aplikuar për herë të parë për ndihmë ekonomike më 05.05.2020. Ajo ka përfituar ndihmë me vlerën 10.692 lekë në muaj deri më 30.04.2024. Në muajin maj 2024, gjatë verifikimeve të rregullta, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Durrës ka konstatuar se znj. A. G., vajza e znj. S. G., e cila kishte mbushur moshën madhore 18 vjeç, nuk ishte e regjistruar në sistemin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Kjo situatë ka ndikuar në përjashtimin e familjes nga ndihma ekonomike për një periudhë prej gjashtë muajsh, sipas VKM 597.

Me shkresën nr. 7962/1 prot., datë 03.07.2024, Bashkia Durrës ka konfirmuar përjashtimin e familjes Gashi nga ndihma ekonomike për shkak të mosregjistrimit të A. G., në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA).

Në shkresën nr. 2924/2 prot., datë 02.07.2024, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka sqaruar se përjashtimi i familjeve me anëtarë të aftë për punë që nuk janë regjistruar si punëkërkuar të papunë është në përputhje me ligjin për asistencën sociale.

Organizata “Për Drejtësi Sociale”, ka paraqitur kundërshtime lidhur me mungesën e informacionit për regjistrimin e vajzës së znj. S. G. Ajo pretendon se kjo situatë është diskriminuese, duke theksuar se familjet rome dhe egjiptiane nuk informohen si duhet për detyrimet e regjistrimit në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA)

Nga analizimi i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara rezulton se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Durrës është përgjegjëse për verifikimin e informacionit të ofruar nga administratorët dhe për miratimin e kërkesave për ndihmë ekonomike. Ajo analizon të dhënat dhe siguron që ato të jenë të sakta.

Refuzimi i ankueses për të qenë përfitues e ndihmës ekonomike është kryer nga sistemi përkatës i pikëzimit, i cili bën përzgjedhjen në mënyrë automatike të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Kriteret dhe vlerësimin përkatës e bën sistemi dhe në asnjë rast subjektet kundër së cilave drejtohet ankesa. Në këtë kontekst, rezulton se Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Durrës nuk kanë ndikuar në refuzimin e ankueses si përfituese nga ana e sistemit të pikëzimit, por për shkak të mangësive të konstatuara dhe konkretisht të faktit që mosregjistrimit të znj. A. G., pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

Ndërkohë Bashkia Durrës, si institucion lokal, ka një rol mbështetës, duke ofruar informacion dhe ndihmë për individët që aplikojnë për ndihmë ekonomike. Administratorët shoqërorë luajnë një rol kyç në zbatimin e legjislacionit për asistencën sociale. Ata janë përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, si dhe për verifikimin e statusit socio-ekonomik të individëve dhe familjeve. Në rastin e Znj. G., administratori kishte detyrimin të sigurojë që informacioni për regjistrimin e vajzës në sistemin e punësimit të ishte i saktë dhe i përditësuar.

Në këtë pikë, gjatë seancës dëgjimore të datës 26.09.2024, përfaqësuesit e Bashkisë Durrës u shprehën se znj. S. G., ishte e informuar në lidhje me procedurën për deklarimin që duhet të bëhej pranë Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, pasi ky është një proces për të cilin ajo vetë ka qenë angazhuar në mënyrë periodike dhe ka plotësuar formularët përkatës në çdo rast kur ka aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike që nga viti 2020.

Znj. S. G., ishte e vetëdijshme për nevojën e regjistrimit të vajzës së saj si punëkërkuese e papunë pranë e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, pasi tashmë ishte e njohur me procedurën e plotësimit të formularit të nevojshëm. Megjithatë, në momentin e plotësimit të formularit nga ana e saj, ajo nuk kishte marrë hapat e nevojshëm për të siguruar regjistrimin e vajzës në sistemin e punësimit, gjë që solli këto pasoja. Kjo situatë çoi në përjashtimin e familjes nga ndihma ekonomike, pasi regjistrimi i vajzës së saj si punëkërkuese e papunë është një kriter i rëndësishëm për të përmbushur kërkesat ligjore dhe administrative për të pasur akses në mbështetje financiare.

Gjithashtu, Shërbimi Social Shtetëror Rajonal Durrës informon se kryen takime e trajnime të vazhdueshme me administratorët social të njësive vendore administrative, me qëllim zbatimin e legjislacionit dhe informimin e aplikuesve përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike.

Nga ana tjetër, roli i administratorëve shoqërorë është po ashtu shumë i rëndësishëm. Ata mbajnë përgjegjësinë për mbledhjen e informacionit dhe verifikimin e statusit socio-ekonomik të familjeve. Sipas procedurave të përcaktuara, administratori ka detyrimin të sigurojë që informacioni mbi regjistrimin e individëve në sistemin e punësimit të jetë i saktë dhe i përditësuar.

Në rastin e znj. S. G., pavarësisht njohurisë së saj mbi procedurat, administratori shoqëror, duke qenë i njohur me situatën e kësaj familjeje, duhej ta rikujtonte ose ta informonte në mënyrë më të detajuar për rëndësinë e regjistrimit të vajzës së saj si punëkërkuese. Kjo do të ndihmonte në përmbushjen e kërkesave ligjore për të siguruar aksesin e familjes në ndihmën ekonomike dhe do të parandalonte pasojat e mundshme nga mungesa e regjistrimit.

Pavarësisht sa më sipër, ligjvënësi ka përcaktuar mënyra alternative për të ndihmuar ato familje që nuk rezultojnë përfituese të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit, duke i trajtuar me me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. Kështu në Pjesën IV, të Vendimit nr. 597/2019, të Këshillit të Ministrave, është parashikuar që Këshilli Bashkiak miraton në fillim të vitit kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese për ndihmë ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit dhe që do të trajtohen me fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, duke përdorur fondin shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike. Familjet në nevojë, në momentin që për zgjidhen nga lista e

familjeve, duhet të kenë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrimit Elektronik Kombëtar për ndihmë ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.

Bashkia Durrës pas njohjes me rastin e znj. S. G., e cila ishte refuzuar nga sistemi elektronik i pikëzimit për të qenë përfituese e ndihmës ekonomike, si dhe duke qenë në dijeni të gjendjes së saj ekonomike i ka akorduar një fond për plotësimin e nevojave të kësaj familje deri në aplikimin e radhës dhe plotësimin e mangësive të konstatuara në aplikimin e parë. Në rastin e znj. S. G., ka pasur një mbështetje nga Bashkia Durrës për të ndihmuar në përmbushjen e nevojave të saj derisa të zgjidhej situata e regjistrimit.

Kjo situatë thekson nevojën për një sistem informimi më të fortë, veçanërisht për grupet vulnerabël. Institucionet duhet të krijojnë mekanizma të qartë për komunikim dhe mbështetje, duke siguruar që individët të kuptojnë plotësisht procedurat. Vetëm përmes një bashkëpunimi të ngushtë mes institucioneve dhe individëve mund të arrihet një akses i drejtë në ndihmën sociale dhe të përmirësohen kushtet e jetesës për ata në nevojë.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se lidhur me çështjen e akordimit të ndihmës ekonomike, e cila është objekt i ankesës së saj, ankuesja nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues nga ana e Bashkisë Durrës, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Durrës, dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Të gjitha këto institucione kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e parashikuara për vlerësimin e kërkesave për ndihmë ekonomike.

Në mungesë të një trajtimi të tillë nuk ekziston diskriminim për shkaqet e pretenduara në ankesë.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 9-10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit për shkak të *etnisë, gjendjes ekonomike, familjare* dhe *çdo shkak tjetër* të znj. S. G., nga ana e Bashkisë Durrës, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Durrës dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Rekomandohet që Bashkia Durrës, Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Durrës dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të ndërmarrin masa për ndergjegjësimin

dhe bashkëpunimin me shtresat vulnerabël. Të krijohet një program informues për procedurat e ndihmës ekonomike sociale, duke organizuar takime informuese në nivel lokal, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe duke vendosur mekanizma monitorimi dhe vlerësimi për të siguruar efektivitetin e iniciativave, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe duke u mbështetur në praktikat më të mira të institucioneve përkatëse për mbrojtjen sociale.

3. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**KOMISIONER**

**Robert GAJDA**